



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:279975  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05719294

**K.Dh.Sh.II.nr.241/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Apetit Sh.P.K., me seli në magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, Obiliq, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.360/23 të datës 30.11.2023, me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e bazuar ankesa e debitori Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.360/23 të datës 30.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.360/23 të datës 30.11.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, kundër urdhrin përmbartimor P.nr.14/23, të datës 14.02.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë dhe në pikën II të dispozitivit mbetet në fuqi i njëjti urdhër për përmbartim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori Komuna e Prishtinës, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin KPPP.nr.360/23 të datës 30.11.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhrin për Përmbarrim P.nr.14/23, të datës 14.02.2023 si dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.360/23 të datës 30.11.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të kthehet lënda në rivendosje.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitori është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Apetit Sh.P.K., me datën 14.02.2023 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarrimit, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 6,443.03 €.

Përmbarruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.14/23, të datës 14.02.2023, duke lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës 2022-SHV01-015-6896 të datës 10.09.2020; 2022-SHV01-015-1090 të datës 10.02.2021; 2022-SHV01-015-2341 të datës 26.03.2022; 2022-SHV01-015-5769 të datës 25.07.2022; 2022-SHV01-015-5876 të datës 27.07.2022; 2022-SHV01-015-5921 të datës 28.07.2022; 2022-SHV01-015-5970 të datës 29.07.2022; 2022-SHV01-015-6046 të datës 01.08.2022; 2022-SHV01-015-6073 të datës 02.08.2022; 2022-SHV01-015-6128 të datës 03.08.2022; 2022-SHV01-015-6166 të datës 04.08.2022; 2022-SHV01-015-6206 të datës 05.08.2022; 2022-SHV01-015-6305 të datës 08.08.2022; 2022-SHV01-015-6371 të datës 10.08.2022; 2022-SHV01-015-6406 të datës 11.08.2022; 2022-SHV01-015-6444 të datës 12.08.2022; 2022-SHV01-015-6526 të datës 15.08.2022; 2022-SHV01-015-6574 të datës 17.08.2022; 2022-SHV01-015-6610 të datës 18.08.2022; 2022-SHV01-015- 6642 të datës 19.08.2022, dhe 2022-SHV01-015-6683 të datës 22.08.2022, me të cilat e ka urdhëruar debitorin

që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 6,443.03 €, me kamatë vonës sipas LMD-së, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.360/23 të datës 30.11.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, kundër urdhrit përbarimor P.nr.14/23, të datës 14.02.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë dhe në pikën II të dispozitivit mbetet në fuqi i njëjti urdher për përbarim.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret, fatura si dokument i besueshëm rezulton se i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 par. 1 nën para. 1.3 të LPP-së ku përcakton se: *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm dhe dokument i besueshëm sipas këtij ligji është fatura”*, ndërsa neni 29 par. 3 të LPP-së thuhet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti - Faturës 2022-SHV01-015-6896 të datës 10.09.2020; 2022-SHV01-015-1090 të datës 10.02.2021; 2022-SHV01-015-2341 të datës 26.03.2022; 2022-SHV01-015-5769 të datës 25.07.2022; 2022-SHV01-015-5876 të datës 27.07.2022; 2022-SHV01-015-5921 të datës 28.07.2022; 2022-SHV01-015-5970 të datës 29.07.2022; 2022-SHV01-015-6046 të datës 01.08.2022; 2022-SHV01-015-6073 të datës 02.08.2022; 2022-SHV01-015-6128 të datës 03.08.2022; 2022-SHV01-015-6166 të datës 04.08.2022; 2022-SHV01-015-6206 të datës 05.08.2022; 2022-SHV01-015-6305 të datës 08.08.2022; 2022-SHV01-015-6371 të datës 10.08.2022; 2022-SHV01-015-6406 të datës 11.08.2022; 2022-SHV01-015-6444 të datës 12.08.2022; 2022-SHV01-015-6526 të datës 15.08.2022; 2022-SHV01-015-6574 të datës

17.08.2022; 2022-SHV01-015-6610 të datës 18.08.2022; 2022-SHV01-015- 6642 të datës 19.08.2022, dhe 2022-SHV01-015-6683 të datës 22.08.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbardim, i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta përmban nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe ka dëshmi se fatura është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e po ashtu fatura përmban edhe kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe ka tipare të përmbardueshmërisë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbardimore me rastin e vendosjes për refuzimin të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se faturat e lëshuar nga ana e kreditorit përmban nënshkrim nga debitori, dhe përcakton kohën e përmbushjes. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 i LPP-së, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Ndërsa sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së thuhet se : *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbardimore, respektivisht është lejuar përmbardimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat i përmbajnë

nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Po ashtu, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të debitori, lidhur me at se faturat nuk i ka nënshkruar personi i autorizuar, si dhe nuk e përmbajnë afatin ligjor për pagesë, por këto pretendime janë të pa bazuar për shkak se faturat në fjalë janë të nënshkruara si nga kreditori ashtu edhe nga ana e debitori, që nënkupton se ato janë të pranuar nga debitori po ashtu në shkresa të lëndës nuk rezulton se debitori i ka kundërshtuar të njëjtat në afatin ligjor, e për më tepër në secilën faturë figuron edhe data e pagesës gjegjësisht figuron data e lëshimit të faturës dhe skadimi i faturës. Andaj të njëjtat paraqesin bazë të dokumentit përmbartimor për lejimin e përmbartimit në kuptim të nenit 29 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Andaj, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbartues, përfshirë edhe

gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e shkallës së dytë**  
K.Dh.Shk.II.nr.241/24 dt. 21.05.2024

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija-Ymeri